

Në pajtim me nenin 173 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82/2018), me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës nr. 18-859/1 të datës 20.06.2019, e në lidhje me Konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Fakultetin Filologjik për lëndët mësimore Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji I, Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji II, Shkrim akademik III, Shkrim akademik IV, të shpallur më 14.05.2019 në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës është formuar Komisioni Recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Marija JANEVA, prof. ordinar – kryetar
1. Prof. dr. Sonja NOVOTNI, prof. ordinar – anëtar
2. Prof. dr. Dervish ALIMI, prof. inordinar – anëtar

Pas marrjes së konfirmimit që jemi anëtarë të Komisionit Recensues, të zgjedhur prej Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës për të shqyrtuar dhe për të vlerësuar krijimtarinë shkencore, profesionale dhe veprimtarinë shkencore të kandidatit Doc. Dr. Arburim ISENI, dhe pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë vërtetoi që në konkursin e shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” më 14.05.2019 për zgjedhjen profesor në thirrje profesor inordinar për lëndët e shpallura në konkurs, edhe ate: Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji I, Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji II, Shkrim akademik III, Shkrim akademik IV, ka aplikuar vetëm kandidati Doc. Dr. Arburim ISENI, dhe pasi që dosja e aplikimit përmban të gjithë dokumentacionin e paraparë në konkurs, kemi kënaqësinë të paraqesim këtë:

Raport recenzues - R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT NËTHIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE **PROFESOR INORDINAR PRANË FAKULTETIT FILOLOGJIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Me datën 14/05/2019 në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur konkurs për zgjedhjen e një profesori universitar në Fakultetin Filologjik për lëndët: Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji I, Gramatika e gjuhës angleze – Morfologji II, Shkrim akademik III, Shkrim akademik IV. Komisioni i lartëpërmendur pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar konstaton se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat edhe ate Doc. Dr. Arburim ISENI, i punësuar me orar të plotë si Docent në Fakultetin Filologjik pranë Universitetit të Tetovës.

Të dhëna biografike të kandidatit

Kandidati **Doc.dr. Arburim Iseni** është lindur më datë 15.05.1976 në fshatin Mateç.

Shkollimi

Shkollën fillore e ka kryer në fshatin Mateç, kurse shkollën e mesme në gjimnazin e Kumanovës. Studimet deridiplomike i ka kryer më 29 shtator 1999, në kuadër të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze me notën mesatare **9.18**. Studimet pasdiplomike i ka kryer 05.06.2006, në Universitetin Shtetëror të Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, dega e gjuhës dhe letërsisë angleze, drejtimi i gjuhësisë me notën mesatare **9.50**, me titull “*Error Analysis in Albanian Speakers’ English Writings*” dhe ka marrë gradën shkencore *Magjistër i Shkencave Filologjike*. Studimet e doktoraturës i ka kryer në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Dega e Gjuhës Angleze në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, më 23.08.2013 dhe ka mbrojtur me sukses tezën e disertacionit me titull: “*Albanian Students’ Errors in Spoken and Written English and the Role of Error Correction in Assessment and Self-Assessment*” dhe ka fituar gradën shkencore *Doktor i Shkencave Filologjike*.

Doktoraturën e dytë e ka kryer në Universitetit Shën Kirili dhe Metodi pranë Fakultetit Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup me temën: „Сличностите и разликите меѓу Канонот на Лека Дукаѓини и Аралот на Западните кодови“.

Doc.dr. Arburim Iseni që nga diplomimi i tij më 29.09.1999 e në vazhdim është pedagog i gjuhës angleze në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, pranë programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Në vitet 2001-2003 ka qenë ushtrues detyre përgjegjës i departamentit të gjuhës dhe letërsisë angleze dhe gjithashtu edhe në periudhën 2009–2011 pranë këtij universiteti. Që nga viti 1999 ka ligjeruar lëndët, si vijon: Metodologjia e Mësimdhënies së gjuhës angleze I,II. Historia e gjuhës angleze. Gjuhë bashkëkohore angleze I,II,III,IV,V,VI,VII,VIII. Gramatika e gjuhës angleze–Fonetikë dhe Fonologji I,II. Bazat e gramatikës së gjuhës angleze I,II. Gramatika e gjuhës angleze–Morfologjia I,II. Gramatika e gjuhës angleze – Sintaksë I,II. Gramatika e gjuhës angleze–Leksikologji I,II. Shkrimi akademik I,II. Letërsia angleze I,II,III,IV,V,VI,VII. Stilistika e gjuhës angleze. Hyrje në studimet e gjuhës angleze. Probleme të veçanta në nxënien e gjuhës angleze. Zhvillimi i gjuhës standarde I,II.

Aktualisht ligjeron lëndët: Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I,II, Mësim interaktiv I, II dhe Shkrim akademik III, IV.

Doc.dr. Arburim Iseni flet rrjedhshëm gjuhën gjermane dhe gjuhën serbe. Ka njohuri themelore të gjuhës frenge. Kandidati ka publikuar studime në shumë revista lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Veprimtaria shkencore dhe botuese e kandidatit Doc.dr. Arburim Iseni

Sasia e punës shkencore e kandidatit Doc.dr. Arburim Iseni paraqitet e konsiderueshme dhe e larmishme. Kandidati Doc.dr. Arburim Iseni ka një veprimtari të gjërë kërkimore shkencore dhe një aktivitet të pasur botues.

- Kryetar dhe themelues i Shoqata-Instituti për gjuhë angleze dhe studime Amerikane, Tetovë – Maqedoni.
- Anëtar i grupit hulumtues për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti Murcia, Spanjë.
- Redaktor përgjegjës dhe themelues i revistës ndërkombëtare **ANGLISTICUM**. E-ISSN: 1857-8187. P-ISSN: 1857-8179
- Ka qenë kryeredaktor i revistës ndërkombëtare **IDEST** dhe pastaj edhe i **SUT Scientific Observer**.
- Anëtarë i komitetit redaktues në revistës prestigjioze ndërkombëtare **Porta Linguarum** ISSN: 16977467
- Anëtar i bordit redaktues në revistën ndërkombëtare **Language Testing in Asia** ISSN: 2229-0443
- Ka qenë anëtarë në redaksinë e revistës **Vizione** 1857-9221
- Anëtar i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare **American Journal of Educational Research** ISSN: 2327-6150
- Anëtarë i këshillit redaktues pranë revistës prestigjioze ndërkombëtare **Journal of Education and Practice** ISSN: 2310-3868

- Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim **Journal of Education** ISSN: 2347-8225
- Redaktor i revistës ndërkombëtare për edukim **ICT & Innovations in Education** ISSN: 2321 – 7189
- Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkenca shoqërore dhe humane **American Journal of Social Issues and Humanities** ISSN: 2276-6928
- Recensues në redaksinë e revistës ndërkombëtare **Teaching English with Technology** ISSN 1642-1027
- Asistent editorial i revistës ndërkombëtare **UNIVERSI** ISSN: 1857-9469
- Anëtar në redaksinë e revistës ndërkombëtare për shkencë dhe teknologji inovative **Journal of Science and Innovative Technologies** e-ISSN 2616-4418; p-ISSN: 2521-1447

Punime të publikuar në revista të recensuara ndërkombëtarisht

1. Iseni, A. (2011). Assessment, Testing and Correcting Students' Errors and Mistakes. *Language Testing in Asia*. 1(3), pp.60-90. DOI: 10.1186/2229-0443-1-3-60.
2. Iseni, A. (2012). Approaching Environmental Literary Education in the 21 st Century. *Research on Humanities and Social Sciences*. ISSN 2224-5766 (Paper) ISSN 2225-0484 (Online) Vol.2, No.5, 2012
3. Iseni, A. (2012). Wine-Making, Dream-Telling: Niki Caro's the Vintner's Luck. *Journal of Education and Practice*, 3(8), 239-244.
4. Iseni, A. (2013). A Portrait of the Artist as a Young Man: Lost Homosocial Desire in Ambiguous Identity. *Journal of Education and Practice* ISSN 2222-1735 (Paper) ISSN 2222-288X (Online). Pp. 286-296.
5. Iseni, A. (2013). Mistakes Made by a Group of Albanian Students of English during their Classroom Oral Interactions. *Journal of Education and Practice* p-ISSN 2222-1735; e-ISSN 2222-288X, 4(21), 2013.
6. Iseni, A. (2013). A Comparative Study of Albanian Customary Law with the Code of the West and the Common Law of England Lex Scripta vs. Lex Non Scripta. *Journal of Law, Policy and Globalization*. Volume 18. Pp. 50-59.
7. Iseni, A.(2013). Angela's Ashes: Class Struggle and the Dream of Betterment. *Research on Humanities and Social Sciences* p-ISSN 2224-5766; e-ISSN 2225-0484. Vol.3, No.17.
8. Iseni, A. (2015). Science and University Education: One Subjective Point of View about Foreign Teachers. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 1(2), 31-36. P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187
9. Iseni, A. (2015). Alistair Macleod's Writing as an Apology to Scottish Heritage in Canadian Literature. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 1(3, 4). P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187
10. Iseni, A. (2016). Conjunction as an Element of Cohesion in English and Albanian Language. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(2), 85-101. P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187
11. Iseni, A. (2016). Challenges of Change in Compulsory Educational System. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(3), 65-72. P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187

12. Iseni, A. (2016). Understanding and Responding to Language Errors. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. 2(3), pp. 222-229. P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187
13. Iseni, A. (2016). The Role of Discourse Markers and Cohesive Devices in Writing: EFL Students a Case Study. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(4), 35-48. P-ISSN: 1857-8179, E-ISSN: 1857-8187.
14. Iseni, A. (2011). Advantages And Disadvantages of Bilingualism by Uriel Weinreich And Einar Haugen. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 1(1), 12-19.
15. Iseni, A. (2013). Folk Elements of Mitrush Kuteli and Nikolay Gogol as forms of Intertext. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187. 2(5). Pp. 118-123.
16. Iseni, A. (2013). Literary Encounters and Women's Writing: Woolf, De Beauvoir, Brovina and Castellanos. *FILOLOGJIKA*. Journal of the Faculty of Philology – SUT, Volume 1, Number 1.
17. Iseni, A. (2008). The Use of the Dictionary in the Classroom. *IDEST: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 1. June 2008. p-ISSN: 1857-6079.
18. Iseni, A. (2008). NGOs Attracting Foreign Direct Investments (FDI) and Influence in the Society. *IDEST: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 1. June 2008. p-ISSN: 1857-6079.
19. Analiza e gabimeve të folësve burimorë të shqipes në shkrimet në gjuhën angleze. *VIZONE: Revistë e shkencave shoqërore*. ISSN 1409-8962.
20. Canadian Literature of Scottish Origin: An Approach to Alistair Macleod's Short Stories *Seminari i VI Ndërkombëtar i Albanologjisë*. Pp.152-158. ISBN 978-608-217-004-6
21. Iseni, A. (2009). Co-Teaching. Meeting the Needs of all Students. Two Heads are better than one. *IDEST: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 2. April 2009. Pp.78-81.
22. Iseni, A. (2011). Some Strategies on How to Help Students with Reading Problems. *Conference Proceedings*, 2-3 December 2011. Session VII Learning Disabilities. Faculty of Education. University "Aleksandër Moisiu", Durrës, Albania. ISBN: 978-99927-685-9-4.
23. Iseni, A. (2009). Literary Approach to James Joyce's "A Portrait of the Artist as a Young Man" *IDEST: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 2. April 2009. pp. 37-46. p-ISSN: 1857-6079.
24. Iseni, A. (2010). Error Detection in the Albanian Speakers' English Writing. With Special Emphasis on Morphological Errors. *SUT Scientific Observer: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 1. June 2010. Pp. 18-25. p-ISSN: 1857-6915.
25. Iseni, A. (2013). The Impact of the Moral and Legal Foundations of the Albanian Society across Europe and Beyond. *Journal of International Affairs and Global Strategy*. ISSN 2224-574X (Paper). ISSN 2224-8951 (Online). Volume 17, 2013.
26. Iseni, A. (2013). Comparing Languages through the Process of Story Making. The Reception of Linguistic Structures from Teacher's Training Students in Spain.

- ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(2). P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187
27. Iseni, A. (2008). Teachers Attitudes Towards Correcting Students Writing Errors and Mistakes. *International journal 'PORTA LINGUARUM'* Nr. 10, June 2008, Spain.
 28. Iseni, A. (2006). Gabimet në shkrimet në gjuhën angleze – *FAKTI*, 9 shtator 2006.
 29. Iseni, A. (2007). Teacher's thoughts about gender gap – Analysis of Academic reality at Secondary school and future perspectives. *VIZIONE*, 2007.
 30. Iseni, A. (2011). The Principles of Testing and Assessment for Correcting Students' Errors *ULTIMATE TEACHER*. English Language Teachers' Association Publication. No.5. April 2011. Pp.14-21. ISBN: 978-99956-813-0-2.
 31. Iseni, A. (2005). Problemi i gabimeve me shkrim që i bëjnë studentët e Evropës Juglindore në Tetovë – pp.307-331. *UNIVERSITAS*, Tetovë / Tetovo; Vjenë / Vienna – Viti IV. Nr. 6&7, tetor 2005. ISSN 1727-0138.
 32. Distinctive Approach to new Zealand English. *SOUNDS OF NEW ZEALAND*. Volume 1(1) October 2009. pp.99-114. ISBN: 978-84-613-2866-6.
 33. Iseni, A. (2009). Linguistic Approach to James Joyce's "A Portrait of the Artist as a Young Man" *IDEST: Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture*. Issue 3. November 2009. pp. 1-7. p-ISSN: 1857-6079.
 34. Iseni, A. (2013). The Identity of the Irish in Argentina in William Bulfin's "Tales of the Pampas". *DISKUTIME – Revistë Shkencore Ndërkombëtare*. Viti II. Nr.3/4. Prill-Maj 2013. pp. 457-461. ISSN 1857-825X.
 35. Iseni, A. (2014). The Contrastive Analysis of the English *-ing* Clause ss Direct Object and its Albanian Correspondents. *European Scientific Journal, ESJ*, 10(14).
 36. Iseni, A. (2018). Mysticism in John Donne and Lalon Shah: Similarities and Differences. *Angloamericanae Journal*, 2(1), 9-20.
 37. Iseni, A. (2014). Shakespeare and Ibsen: A Comparative Study of Macbeth and Hedda Gabler from 21st Century Radical Feminism Perspective. *Journal of Educational and Social Research*, 4(4), 30.
 38. Iseni, A. (2014). Power And Sexuality in Henrik Ibsen's Ghosts. *European Scientific Journal, ESJ*, 10(11).
 39. Iseni, A. (2016). Linguistic and Cultural Issues in Translation with Special Reference on Novels of James Joyce, Saul Bellow, and Vladimir Nabokov Translated from English into Albanian by Betim Muço. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 1(1), 20-26.
 40. Iseni, A. (2016). Translation Features of Vedat Kokona on Several Dramas of Shakespeare. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 1(1), 6-11.
 41. Iseni, A. (2005). Problemi i Gabimeve me shkrim që i bëjnë studentë e Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë. Volume 4(6-7). Pp. 307-331. ISSN: 1727-0138.
 42. Iseni, A. (2014). The Challenge of (Non) Implementation of the Ohrid Framework Agreement in the Republic of Macedonia. *European Scientific Journal, ESJ*, 10(10).

43. Iseni, A. (2016). New Media as an Inclusive Dimension of Multiculturalism in Public Communication. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 4, 15-29.
44. Iseni, A. (2016). Public Relations, Mass Media and Informal Education. *European Scientific Journal*, ESJ, 12(19).
45. Iseni, A. (2014). The Mass Media and Persuasion. *European Scientific Journal*, ESJ, 10(14).
46. Iseni, A. (2016). Identity is created Through a Mobilization of 'Self' and 'Other' in Relation to the Malaysian selected Works. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 3(5), 155-161.
47. Iseni, A. (2013). Angela's Ashes: Class Struggle and the Dream of Betterment. *Research on Humanities and Social Sciences*. ISSN 2222-1719 (Paper) ISSN 2222-2863 (Online). Vol.3, No.17, 2013
48. Iseni, A. (2015). Perception of the Supernatural Worlds in Shakespeare's *The Tempest*. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 3(6), 23-34.
49. Iseni, A. (2015). Symbolic Realism in Ibsen's *A Doll's House*: An Overview. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 3(8), 8-17.
50. Iseni, A. (2016). Comparing Languages Through the Process of Story Making. The Reception of Linguistic Structures from Teacher's Training Students in Spain. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 2(2), 44-52.
51. Iseni, A. (2014). Anita Desai's Novels as Post-Modernist Feminist Projections. *European Scientific Journal*, ESJ, 10(14).
52. Iseni, A. (2013). Virtual learning in higher education. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*. P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 2(4), 262-278.
53. Iseni, A. (2016). De Rada's Position in the Albanian Literature. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, P-ISSN 1857-8179; e-ISSN 1857-8187, 5(11), 23-26.
54. Iseni, A. (2014). Fading Away into the Future: Reconsidering Adult - Child Relationship in a Discourse of Affect. *ARS ARTIUM*. 2(1), ISSN: 2319-7889.
55. Iseni, A. (2016). Elementët e ngjashmërisë dhe intonacionit narrativ midis Kutelit, Turgenievit dhe Gogolit. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(4), 63-70.
56. Iseni, A. (2016). Elementet folklorike të Mitrush Kuteli dhe Nikolaj Gogoli si formë interteksti. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 2(5), 118-123.
57. Iseni, A. (2014). Some Moments of Distortion of Reality in Iris Murdoch's Novel "Under The Net". *European Scientific Journal*, ESJ, 10(14).
58. Iseni, A. (2014). Stylistic Analysis of A Portrait of the Artist as a Young Man from Lexical and Grammatical Category. *European Scientific Journal*, ESJ, 10(14).
59. Iseni, A. (2014). The Struggle of Eros against Thanatos in the Novel "Lady Chatterleys Lover" by DH Lawrence. *European Scientific Journal*, ESJ, 10(11).

60. Iseni, A. (2014). David Herbert Lawrence an Icon of Modernism. *European Scientific Journal, ESJ*, 10(11).
61. Iseni, A. (2017). Authenticity in Language Testing. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 6(8), 9-14.
62. Iseni, A. (2018). Teaching Business English. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 7(3), 63-71.
63. Iseni, A. (2015). Henrik Ibsen and Indian Bengali Literature: A Stage Production Perspective. *ANGLISTICUM. Journal of the Association for Anglo-American Studies*, 4(1), 8-15.

Studimet dhe hulumtimet e tij janë të shumta e të vazhdueshme; në punët e tij gërshetohet përvoja botërore me mendimin personal. Kualifikimet e kurset e shumta, kontaktet me arritjet bashkëkohore e botimet e fundit dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore në Europë, sidomos në Angli, kanë ngritur dukshëm nivelin shkencor të veprave e të prodhimit shkencor të tij. Ka botuar shumë artikuj në revista shkencore jashtë vendit, të cilësisë me ISSN, si dhe artikuj në revista të ndryshme shkencore me faktor impakti, ku këtë vit edhe është fitues i dy çmimeve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës pranë Republikës së Maqedonisë për këso lloj publikimesh.

Për t'u theksuar është pjesëmarrja e tij aktive me dhjetra kumtesa e referate në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare në Spanjë, Itali, Gjermani, Angli, Shqipëri, Bruksel, Sicili, Kosovë, etj; bashkëpunimi i shumëanshëm me mjaft universitete të huaja, amerikane dhe europiane; botimi i shumë kumtesave dhe artikujve në organe botuese të shumta europiane, përfshirë edhe revistat tona universitare. Si rezultat i këtij aktiviteti ka referuar apo prezantuar 11 tema e kumtesa në konferenca e takime shkencore ndërkombëtare jashtë vendit, si dhe 9 kumtesa e prezantime në konferenca e takime shkencore brenda vendit. Ka marrë pjesë në 9 konferenca shkencore jashtë vendit si dhe është trainuar në 11 seminare e workshop-e nga një javë deri 2 muaj në Maqedoni dhe në vende të ndryshme të Evropës.

Kandidati Doc.dr. Arburim Iseni ka kryer me sukses dy kurse mësimi në distancë për zhvillimin e tij profesional të udhëhequr nga Prof.dr. Armando Lopez Valero pranë Universitetit të Murcias në Spanjë ku njërin e kishte filluar me 5 tetor dhe mbaruar me 19 tetor, 2009 me temën “*Ongoing Story Dramatization and School for Children Education at Primary and Secondary Level*” dhe u shpërblye me certifikatë prej 3 kredi ECTS. Menjëherë pas mbarimit të kursit të parë, kandidati Doc.dr. Arburim Iseni e kishte filluar edhe kursin e dytë me datën 19 tetor dhe mbaruar me datën 30 tetor me temën “*Processes and Strategies for Childhood Education at Primary and Secondary Level*” ku poashtu ishte shpërblyer me certifikatë prej 3 kredi ECTS. Ka fituar çmimin për cilësi më të mirë për botimin e revistës IDEST pranë departamentit të anglishtes nga COLLEGE READING ASSOCIATION me seli ne Utah, USA.

Veprimtaria e gjërë kërkimore-shkencore e Doc.dr. Arburim Iseni është fryt i një pune të gjatë e intensive, i një praktike mësimdhënëse shumë vjeçare, i njohjes së disa gjuhëve të huaja, i kualifikimit e specializimit të vazhdueshëm, është fryt i përditësimit të njohurive të tij shkencore me përvojën më të përparuar botërore në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze; ku ai sjell me kompetencë të lartë përvojën anglo-

amerikane në mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e huaj, konkretisht gramatikën e gjuhës angleze, duke hapur shpesh rrugë të reja në këtë fushë. Puna shkencore e kandidatit ka një shtrirje mjaft të gjerë. Ajo përfshin drejtime të ndryshme të gjithë sistemit arsimor kombëtar, duke përfshirë si arsimin parauniversitar ashtu edhe atë universitar. Ka kryer studime, ka referuar e botuar për drejtime të tilla si metodologjitë e të mësuarit, metodologjitë e mësimit të gjuhës së huaj, për probleme të ndryshme të edukimit, etj. Cilësia e punës shkencore të kandidatit Doc.dr.Arburim Iseni është e një niveli të lartë, frut i këmbënguljes dhe skrupulozitetit të tij në kërkime, vëzhgime, konsulta e studimin e literaturës. Në tekstet, artikujt e botuar si dhe në referatet dhe kumtesat e mbajtura vihet re cilësia e metodologjive të përdorura dhe e gjykimit shkencor. Veçojmë sidomos tekstet: 1. *A Practical English Grammar, Tetovë 2006*. 2. *The Origin and History of the English Language, Tetovë 2007*. 3. *Modern English Grammar, Tetovë 2008*. Veprimtaria e kandidatit Doc.dr. Arburim Iseni përfaqëson një kontribut të rëndësishëm me dimensione kombëtare në të gjitha ciklet e arsimit shqiptar. Me studimet dhe botimet e tij ai ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në hartimin e standardeve të mësimit të gjuhëve të huaja, në përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies së gjuhëve të huaja në tërësi dhe gramatikës së gjuhës angleze në veçanti, si për arsimin parauniversitar, ashtu edhe atë universitar. Impakti i punës shkencore të kandidatit shoqërohet me një impakt të rëndësishëm në fushën e edukimit (hartimi i kurrikulave), si dhe në formimin e mësuesve, duke u shtrirë në të gjitha ciklet e arsimit.

Karakteri udhëheqës i veprimtarisë së kandidatit Doc.dr. Arburim Iseni është i manifestuar në disa projekte, në punën e tij si drejtues i njësisë universitare, si përgjegjës departamenti e më pas si koordinator fakulteti për ECTS dhe koordinator për studimet e ciklit të dytë–Master. Gjithashtu Doc.dr. Arburim Iseni ka udhëhequr me cilësi shumë diploma universitare të nivelit Bachelor, si dhe dhjetëra diploma të nivelit Master pranë Universitetit të Tetovës.

Vlerësimi Metodiko Shkencor

Komisioni i profesorëve për vlerësimin e procedurës së fitimit të titullit *Profesor inordinar* pasi kishte vëzhguar orët mësimore të paraqitura prej Doc.dr. Arburim Iseni në kërkim të titullit *Profesor inordinar* konfirmon se ato i plotësojnë kriteret për mbrojtje para jurisë. Po ndalemi në disa aspekte që na bëjnë të japim disa reflektime për demonstrimin e aftësive shkencore dhe profesionale të Doc.dr.Arburim Iseni: Mësimdhënia e një gjuhe të huaj trajton një çështje aktuale, temën e përvetësimit të një gjuhe të huaj si një prej kompetencave kyçe, të përcaktuara edhe nga korniza arsimore e BE-së në kontekstin e një bote gjithnjë e më ndër-kulturore dhe globale, dhe që si e tillë, mësimdhënia e tij ka rëndësi të veçantë për disa arsye: a) Të mësuarit e një gjuhe të huaj ka kohë që është një aftësi mbarë botërore e konsideruar prioritet, e cila është në qendër të vëmendjes së shoqërive të sotme, perëndimore dhe lindore; b) Të mësuarit e një gjuhe të huaj në shkollë dhe jashtë saj është shndërruar në një shqetësim psiko-pedagogjik sidomos në këto dy dekadat e fundit edhe në Maqedoni; c) Të mësuarit e një ose më shumë gjuhëve të huaja në shkollë dhe jashtë saj ka ndikimet e veta në jetën e individëve, por edhe të shoqërisë dhe prandaj fokusi në mësimdhënien e tij është ndihmues në zgjidhjen e problematikave ekzistuese.

Metodat e përdorura

Të gjitha leksionet ishin të përgatitura me PowerPoint, dallohej përditësimi i vazhdueshëm, përdorimi i literaturës bashkëkohore, mësimi interaktiv, jo thjeshtë leksione ex-katedra, etj. Doc.dr. Arburim Iseni iu kushton vëmendje të veçantë zbatimit në praktikë të metodave bashkëkohore dhe alternative, kryesisht metodave me qendër studentin, etj. Vlerat e orëve mësimore që i kemi të vëzhguara te Doc.dr. Arburim Iseni mund të grupohen në disa aspekte që po i përmendim në vazhdim:

Në aspektin informues

Orët e mësimimit treguan se pedagogu ka një informacion të gjerë për kontributet teorike për konceptimin e mësimdhënies në gjuhë të huaj, si dhe për zhvillimin e aftësive të komunikimit gjuhësor në komponentët bazë: të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të lexuarit, duke u ndalur në raportet me gjuhën angleze. Kontributet teorike u përzgjodhën dhe integruan mjaft mirë në funksion të qëllimit të mësimimit. Mësimdhënia e tij tregoi nivelin e lartë të përvetësimit të informacionit për kërkimet dhe studimet e kryera në fushën e gramatikës nga institucione, organizata dhe studiues të ndryshëm. Mësimdhënia dha për të gjithë të pranishmit një informacion konkret nga konteksti lokal, i mbledhur në punën e gjatë të kandidatit profesor në fushën e gramatikës së gjuhës angleze.

Në aspektin shkencor

Orët e mësimimit ishin të ndërtuara mbi bazën e metodologjive bashkëkohore, të përcaktuara në shërbim të detyrës mësimdhënëse dhe nxënies, si dhe tematikës së trajtuar. Mësimdhënia e Doc.dr. Arburim Iseni garanton besueshmëri të përmbajtjes duke u përpjekur kështu të përfshijë çështjet më përfaqësuese të gramatikës së gjuhës së huaj, në këtë rast asaj angleze. Rezultatet e mësimimit pasqyrojnë me përpikëri perceptimet e objekteve dhe subjekteve të mësimimit.

Në aspektin praktik

Mësimdhënia e demonstruar nga Doc.dr. Arburim Iseni ka vlera praktike për studentët, pedagogët dhe didaktët e arsimit, për specialistët e arsimit, për hartuesit e teksteve shkollore gjegjësisht të gramatikës së gjuhës angleze, për mësuesit e niveleve të tjera të shkollimit, prindërit dhe gjithë të interesuarit e çështjes së mësimdhënies. Mësimdhënia e prezantuar mund të përfshihet në rekomandimet që ndihmojnë në aktivizimin e strategjive për hartimin dhe mësimdhënien e manualeve të mësuesve të gjuhës angleze dhe të gjuhëve të huaja në përgjithësi, rekomandime që do të ishin një ndihmesë konkrete për përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore dhe atyre që bashkëpunojnë me to në këtë fushë, por edhe të mësuesve që ndeshen me problematikat e të mësuarit të gramatikës së gjuhës së huaj.

Përfundim dhe propozim

Komisioni recenzues pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit i cili ka konkurruar, dhe bazuar në nevojat për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, dhe nga e sipërpërmendura mund të përfundojmë se me veprimtarinë e tij të suksesshme në mësimdhënie dhe nivelin e duhur të dijes, veprimtarisë, interesimit dhe angazhimit të tij në problematikën shkencore, Doc.dr. Arburim Iseni i plotëson kushtet ligjore për t'u zgjedhur në thirrjen për të cilën ka konkurruar. Në fushën e mësimdhënies ai posedon aftësi për mësimdhënie cilësore. Punimet shkencore në revista të shquara dhe pjesëmarrja e tij në konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare qartë dëshmojnë për profilizimin dhe gatishmërinë për t'i përcjellur çdoherë pyetjet aktuale nga fusha e gjuhësisë angleze, dhe gjithashtu për gatishmërinë për përcjelljen e pyetjeve aktuale edhe përsa i përket problematikës historiko-letrare të gjuhës angleze. Këto njohuri ai në mënyrë shumë të suksesshme i implementon në praktikën e deritashme të tij shkencore dhe hulumtuese në skenën vendore dhe ndërkombëtare. Besojmë se zgjedhja e tij do të sjellë shumë rezultate në nxitjen e proceseve edukative, shkencore dhe hulumtuese në programin studimor të gjuhës dhe letërsisë angleze pranë Universitetit të Tetovës. Për këtë arsye është nder dhe kënaqësi për ne t'i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor pranë Fakultetit Filologjik, programit studimor të gjuhës dhe letërsisë angleze, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që:

1. Doc.dr. Arburim Isenin të zgjedh në thirrjen Mësimore-Shkencore **Profesor inordinar** pranë Universitetit të Tetovës, Fakulteti Filologjik, në fushën e gjuhësisë angleze për lëndët: **Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I; Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II; Shkrim akademik III; Shkrim akademik IV.**

Komisioni recenzues:

Prof. dr. Marija JANEVA, prof. ordinar – kryetar

Prof. dr. Sonja NOVOTNI, prof. ordinar – anëtar

Prof. dr. Dervish ALIM, prof. inordinar – anëtar

V. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Arburim ISENI ka grumbulluar gjithsej **1188.7** pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **654.2** pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese **492**, veprimtarinë profesionale-aplikative **28.5** pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë **14** pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKË
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	654.2
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	492
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	28.5
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	14
Gjithsej	1188.7

SHTOJCË

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Arburim Besnik ISENI

Institucioni: Fakulteti Filologjik-Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lëmi shkencore: *Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I* (semestri dimëror), *Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II* (semestri veror), *Shkrim akademik III* (semestri dimëror), *Shkrim akademik IV* (semestri veror).

1. Shtojcë veprimtarie për **zgjedhje** në një titull shkencor mësimor

Kandidati: **Arburim B. ISENI**

Institucioni: Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tetovës

Fusha: Gjuhë dhe Letërsi Angleze

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
I. Mbjajtja e ligjëratave (Lëndët ne ciklin e parë të studimeve)		
I.	Programi studimor – Gjuhë dhe letërsi angleze	
	Pregatitje të lëndëve të reja – (ligjerata)	1.5
I.1	Mbjajtja e ligjëratave: Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.2	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.3	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia I (ushtrime)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.4	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.5	Mbjajtja e ligjëratave: Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II – (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.6	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.7	Gramatika e gjuhës angleze – Morfologjia II (ushtrime)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.8	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.9	Pregatitje të lëndëve të reja-Mësim interaktiv I (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$

I.10	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.11	Pregatitje të lëndëve të reja – Mësim interaktiv I (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.12	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.13	Pregatitje të lëndëve të reja – Mësim interaktiv II (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.14	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.15	Pregatitje të lëndëve të reja – Mësim interaktiv II (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.16	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.17	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik I (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.18	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.19	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik I (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.20	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.21	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik II (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.22	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.23	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik II (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.24	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.25	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik III (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.26	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.27	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik III (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.28	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.30	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik IV (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.21	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.32	Mbajtja e ligjeratave: Shkrim akademik IV (ushtrime)	$1 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
I.33	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
I.34	Mbajtja e ligjeratave: Gramatika e gjuhës angleze – Fonetikë dhe Fonologji I (ligjerata)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.35	Pregatitje të lëndëve të reja (ushtrime)	1.5
I.36	Mbajtja e ligjeratave: Gramatika e gjuhës angleze – Fonetikë dhe Fonologji I (ushtrime)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.37	Pregatitje të lëndëve të reja (ligjerata)	1.5
